

# PROGRAMI I LËNDËS SË MUZIKËS

Nëntor, 2014

**SHKALLA E TRETË**

## Përmbajtja e Programi

I.	Hyrje .....	4
II.	Korniza konceptuale e programit.....	6
1.	Qëllimet e programit të muzikës .....	10
2.	Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës .....	11
3.	Lidhja e muzikës me temat ndërkurrikulare.....	13
4.	Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare.....	14
5.	Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj .....	16
6.	Ndarja e kohës mësimore për tematikë për secilën klasë.....	21
III.	Përmbajtja e shkallës së tretë .....	22
1.	SHKALLA E TRETË.....	22
1.1	Tematika : Gjuha dhe komunikimi muzikor.....	23
1.2	Tematika: Teknika dhe procese muzikore .....	25
1.3	Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria .....	28
V.	Udhëzime metodologjike .....	41
VI.	Udhëzime për vlerësimin .....	42
VII.	Materiale dhe burime mësimore.....	43

## **Tabelat dhe diagramet**

Digrama 1: Korniza konceptuale e programit.....	8
Digrama 2: Rezultatet e të nxënit të komptencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së muzikës për shkallën e tretë. ....	11
Digrama 3: Lidhja ndërmjet muzikës dhe fushave të tjera. ....	157
Digrama 4 : Kompetencat e lëndës dhe tematikat e lëndës. ....	17
Tabela 1: Kompetencat e lëndës, përshkrimi dhe realizimi i tyre nëpërmjet tematikave të lëndës .....	20
Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë.....	21

Fusha e arteve<sup>1</sup> është pjesë e rëndësishme e kurrikulës në të cilën përfshihen aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, ku ndërveprojnë kultura dhe shoqëria. Mësimi i arteve u afron nxënësve mundësi për të zhvilluar njohuritë artistike përmes mjeteve shprehëse si: tingujve, ngjyrave, formave, fjalës, lëvizjeve. Ato mësohen, formohen dhe kultivohen përmes teknikave e proceseve artistike, nxisin të mësuarit konkret të artit gjatë procesit mësimor në shkollë dhe në jetën e përditshme. Kompetencat lëndore, që zhvillon fusha e arteve në të gjitha shkallët, kontribuojnë në arritjen e kompetencave kyçe, në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës. Fusha e arteve zhvillohet përmes lëndëve: *art pamor, muzikë, kërcim dhe dramë* si lëndë të detyrueshme në ***shkallën e parë , shkallën e dytë , shkallën e tretë*** dhe në ***shkallën e katërt***. Fusha e arteve zhvillohet përmes lëndëve: *art pamor, muzikë dhe dramë* si lëndë të detyrueshme në ***shkallën e tretë*** dhe në ***shkallën e katërt***. Në ***shkallën e tretë***, fusha e arteve, përkatësisht drama, muzika dhe arti pamor fokusohet në aftësimin e nxënësve në krijimin, performimin/interpretimin, komunikimin dhe përdorimin e informacionit muzikor nga burime të ndryshme. Ndërsa në ***shkallën e katërt*** ata fillojnë të krijojnë dhe performojnë/realizojnë në mënyrë më sistematike, vlerësojnë artet duke krijuar gjykime dhe qëndrime të qarta nëpërmjet njohjes së zhvillimit historik të muzikës shqiptare dhe asaj të huaj, duke krijuar kompetenca të qëndrueshme dhe të zbatueshme në këto disiplina artistike. Aspektet e të nxënësve në fushën e arteve, do të zhvillojnë mundësitë e nxënësve për të njohur gjuhën artistike të arteve, për të realizuar dhe për të prezantuar punë të ndryshme artistike, për të vlerësuar veprat e arteve të ndryshme. Artet stimulojnë ndërgjegjësimin trupor, ushqejnë imagjinatën dhe kontribuojnë në zhvillimin e vetëbesimit. Fusha e arteve ndihmon në krijimin e identitetit , në pasurimin e botëkuptimit të nxënësve dhe zhvillimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar nëpërmjet trajtimit të elementeve dhe vlerave artistike kulturore të trashëgimisë sonë kombëtare.

---

<sup>1</sup> Hyrja dhe pjesët e sqaruese të programit, janë njësoj si për shkallën e tretë ashtu edhe për shkallën e katërt. Njohuritë dhe shkathtësitë janë vetëm për shkallën e tretë.

# 1 Hyrje

Muzika qëndron mes të gjitha formave të tjera inteligjente të njeriut (artit në përgjithësi, shkencave shoqërore e historike dhe shkencave artistike), si një përbërës i barabartë me to i progresit intelektual dhe i humanitetit. Kjo tregon që muzika krijon edhe historinë e vet përmes kultivimit e sofistikimit të “këngës” primitive dhe kultivimin e përpunuar të zërit njerëzor e të instrumenteve të muzikës. Të gjitha këto të bashkërenduara e të nënrenduara në procesin e edukimit, do të kërkojnë të trajtohen në mënyrë të veçuar e sistematike në programet lëndore sipas shkallëve. Muzika është një disiplinë artistike e artit dhe gjuhë universale që ndihmon nxënësit të kuptojnë dhe lidhin fenomenet dhe dukuritë muzikore, proceset dhe çështjet që i përkasin muzikës, duke vërtetuar ligjshmërinë e tyre, si dhe duke shpjeguar mënyrat e interpretimit dhe ndërtimit të tyre, gjë e cila çon drejt realizimit të një procesi të suksesshëm të mësimi të muzikës.

Vazhdimi i rrugëtimit të njohjes me muzikën është një vlerë e madhe për të mundësuar edukimin dhe formimin kulturor, zhvillimin e personalitetit të nxënësve, zhvillimin e aftësive të tyre për të punuar dhe krijuar në mënyrë të pavarur e sistematike si dhe për të menduar në mënyrë krijuese dhe kritike.

Integrimi i muzikës me të gjitha lëndët e tjera brenda fushës së arteve dhe fushat e tjera të kurrikulës, si dhe me temat ndërkurrikulare, ka si qëllim që të zotërohen sa më mirë *kompetencat kyçe* dhe ato të lëndës. Muzika është e pranishme kudo në jetën tonë të përditshme ( p.sh. klasë, shtëpi, TV, film, koncert, teatër, kolonë zanore, ngjarje të shënuara familjare, veprimtari brenda dhe jashtë shkollës, ngjarje të komunitetit etj.).

***Fusha e arteve është një nga shtatë fushat e kurrikulës së arsimit bazë dhe përmban katër lëndë brenda saj: arti pamor, muzika, teatri dhe kërcimi.*** Muzika mësohet në të gjitha shkallët e kurrikulës.

Muzika nuk mund të kuptohet dhe realizohet duke marrë vetëm disa njohuri, por duke vazhduar njohjen më të plotë të saj përmes *gjuhës muzikore dhe komunikimit muzikor, zbatimit konkret të veprave muzikore përmes teknikave dhe proceseve, njohjes me zhvillimin kulturor dhe historik të saj*, njohuri që bëjnë të vetëdijshëm nxënësit për rolin e muzikës në jetën e përditshme.

Me anë të muzikës, nxënësit interpretojnë këngë të ndryshme tashmë duke zhvilluar më tej teknikat e këndimit, kuptojnë rëndësinë e këndimit vetëm dhe në grup, duke zbatuar teknikat e të kënduarit, njohin më tej zhvillimin e muzikës dhe kompozitorëve të ndryshëm që bënë epokë me muzikën e tyre.

Lënda e muzikës synon të edukojë dhe formojë nxënësit nga pikëpamja muzikore, duke i orientuar ata me kreativitet drejt kuptimit të veçorive të ligjërimit muzikor nga më e thjeshta te më e ndërlikuara përmes gjuhës dhe komunikimit muzikor, drejt marrjes pjesë dhe interpretimit në veprimtaritë muzikore individuale dhe në grup përmes teknikave dhe procesit muzikor, drejt formimit dhe krijimit të një vlerësimi dhe qëndrimi artistik në njohjen me muzikën shqiptare dhe atë botërore, përmes formave dhe gjinive të ndryshme muzikore.

Mësimi i muzikës në shkollë ka të bëjë me njohjen, të kuptuarit dhe të zbatuarit e koncepteve dhe shprehive muzikore, përmes njohurive muzikore dhe mënyrave të të gjykuarit dhe vlerësuarit të muzikës në veçanti dhe arteve në përgjithësi.

## 2 Korniza konceptuale e programit

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga: korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit bazë. Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit**, për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të lëndës së muzikës, në mënyrë që ata të përballojnë sfidat e jetës dhe të integrohen në shoqëri.
- **Mësuesit**, për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit**, për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara.
- **Hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.


Programi i muzikës ka në thelbin e tij krijimin e kushteve për ndërtimin e **kompetencave të lëndës** si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to. Realizimi i **temave ndërkurrikulare** nëpërmjet lëndës së muzikës është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e muzikës dhe të gjitha arteve të tjera që përbëjnë fushën e arteve, në shoqëri dhe në jetën e përditshme.

Programi, përmban 3 tematika që janë të përbashkëta në të gjitha disiplinat artistike të fushës së arteve dhe krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Në program paraqiten edhe **koha mësimore për secilën tematikë**, që ndryshon nga klasa në klasë.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e muzikës dhe fushave të tjera, në mënyrë që kurrikula e arsimit bazë të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënie në muzikë është kusht për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin artistik, që zotëron brenda vetes. Në këtë program, **vlerësimi i nxënësve** është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënësve.

Digrama 1: Korniza konceptuale e programit





### **3 Qëllimet e APU**

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes.
- përdorin teknologjitë e reja.

#### **4. Qëllimet e programit të muzikës**

Programi i muzikës, nëpërmjet përmbajtjeve të përcaktuara sipas tematikave, ka si qëllim zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe koncepteve për plotësimin e formimit muzikor dhe artistik, zhvillimin e aftësive muzikore të të menduarit kritik dhe krijues, zhvillimin personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve, për të njohur dhe vlerësuar vepra të muzikës shqiptare ku përfaqësohet trashëgimia jonë kombëtare muzikore dhe ajo botërore, nga periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike.

Në programin e muzikës nxënësit përfshihen në veprimtari muzikore tradicionale duke:

- manifestuar vlerat e muzikës kombëtare si pjesë e pandashme e vlerave të artit shqiptar;
- marrë pjesë në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit;
- vënë në shërbim të mjedisit ku jeton aftësitë dhe talentin e vet;
- ndërvepruar në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupet të ndryshme kulturore apo etnike;
- zhvilluar kompetencat muzikore për të krijuar dhe realizuar punë të ndryshme muzikore;
- dhënë kontributin personal në zhvillimet artistike muzikore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

Në programin e muzikës nxënësi mëson të zbulojë ngjashmëritë, ndryshimet, marrëdhëniet në muzikë, eksperimenton nëpërmjet krijimit dhe dëgjimit, zhvillon më tej gjykimin dhe argumentin, duke krijuar një qëndrim të vetin e duke ua paraqitur të tjerëve, edukohet të punojë në grup, ndihet i suksesshëm në muzikë.

## Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit. **Kompetenca** përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies. Organizimi i mësimit të muzikës me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën.

Kur nxënësi realizon kompetencat muzikore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh.: kompetenca e muzikës “Interpretimi/performimi muzikor” përfshin shumë nga teknikat e ndryshme të të kënduarit, të të bërit muzikë apo luajtjes në instrumente muzikore të cilat nxënësit i përdorin në jetën e përditshme.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave muzikore pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e përshtatshmërisë në jetë, shoqëri dhe punë.

Në zhvillimin e kompetencave muzikore, nxënësi gjithashtu, zhvillon kompetencat kyçe në lidhje me krijimtarinë, interpretimin, vlerësimin e muzikës, përpunimin e informacionit për muzikën, prezantimin e detyrave të zhvilluara rreth muzikës që dëgjon apo krijon, prezantimin e punës në grup, komunikimin efektiv etj.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së muzikës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për shkallë për kompetencat e lëndës së muzikës që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetencat e lëndës së muzikës për vit mësimor, rezultatin/et e të nxënit për shkallë;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave muzikore, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet

e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për lëndën e muzikës.

**Digrama 2: Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së muzikës për shkallën e tretë dhe të katërt.**

<b>SHKALLA E TRETË</b>	<b>SHKALLA E KATËRT</b>
<b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• krijon personalitetin e vet në veprimtaritë artistike;</li> <li>• kupton drejt mesazhin artistik;</li> <li>• demonstroi një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, simboleve, shenjave dhe formave muzikore;</li> <li>• shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.</li> </ul>	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike.</li> <li>• gjykon drejt mesazhin artistik;</li> <li>• shprehet nëpërmjet një komunikimi të qartë dhe saktë me anë të gjuhëve, simboleve, shenjave dhe formave muzikore;</li> <li>• shfrytëzon mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme, kritike dhe krijuese.</li> </ul>
<b>Kompetenca e të menduarit</b>	
<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur;</li> <li>• zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike;</li> <li>• zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese;</li> <li>• ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim muzikor.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përpunon njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;</li> <li>• zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike;</li> <li>• zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese;</li> <li>• ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore artistike.</li> </ul>
<b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b>	

<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>klasifikon mjetet për të realizuar një krijim muzikor;</li> <li>përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor;</li> <li>krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</li> </ul>	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>vendos mjetet në funksion të realizimit të krijimit muzikor;</li> <li>përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor;</li> <li>krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</li> </ul>
<b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b>	
<p>Nxënësi:</p> <p>dërrmer nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>drejton aktivitetet muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese.</li> </ul>
<b>Kompetenca personale</b>	
<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive muzikore;</li> <li>përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet;</li> <li>rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe krijimin e besimit te të tjerët.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>krijon besimin tek vetja gjatë veprimtarive muzikore;</li> <li>merr pjesë në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet;</li> <li>ndërgjegjëson veten dhe zhvillon vetëbesimit dhe krijimin e besimit te të tjerët.</li> </ul>
<b>Kompetenca qytetare</b>	
<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;</li> <li>respekton punën e të tjerëve;</li> <li>bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, brenda dhe jashtë shkollës.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>promovon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;</li> <li>respekton punën e të tjerëve;</li> <li>bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.</li> </ul>
<b>Kompetenca digjitale</b>	
<p>Nxënësi:</p>	<p>Nxënësi:</p>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• krijon informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet;</li> <li>• njeh mjetet të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet;</li> <li>• përdor njeh mjetet të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.</li> </ul>
--	---

#### 4 Lidhja e muzikës me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Muzika ka një shumëllojshmëri të veprimtarive në jetën e përditshme dhe është e lidhur me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e shumëfishtë sepse ajo jo vetëm merr në konsideratë shumë nga këto komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështu në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare: *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; trashëgimia kulturore dhe iso- polifonia, të drejtat e njeriut; mjedisi dhe ruajtja e tij nga zhurmat e muzikës; ndërvarësia ndaj muzikës; bashkëjetesa paqësore*, nxënësi kontribuon përmes aktiviteteve muzikore duke shpalosur vlerat e kulturës së vet, duke respektuar dhe promovuar vlerat e kulturave të tjera, duke bashkëpunuar vetëm dhe në grup në aktivitete të ndryshme duke dhënë kontributin e vet, duke u dhënë zgjidhje situatave dhe problemeve të ndryshme muzikore/artistike, duke përdorur gjuhë të saktë muzikore për të komunikuar vlera dhe qëndrime, duke shpjeguar teknika dhe procese të ndryshme muzikore që lidhen dhe me fusha të tjera që ata mësojnë. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave muzikore me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

Nxënësi përdor aftësitë e tij muzikore që kanë të bëjnë me simbole, vizatime, grafikë për të zhvilluar një marrëdhënie aktive në mjedisin e tij. Ai mund të shpjegojë fenomenet dhe dukuritë muzikore në botën e tyre dhe ndërvarësitë e mjedisit dhe botës njerëzore (mjedisi i ndotur nga muzika e lartë dhe e vazhdueshme).

Nxënësi mëson të komunikojë dhe shprehet përmes gjuhës muzikore për të krijuar ide të ndryshme, për të krijuar një punë të vetën muzikore, duke përdorur elementet e gjuhës muzikore, duke eksperimentuar dhe zhvilluar më tej idetë e veta muzikore, duke organizuar krijimin e vet muzikor, sipas elementeve të gjuhës muzikore dhe shprehur atë përmes komunikimit artistik.

Nxënësi fillon të familjarizohet me përmbajtje të ndryshme të veprave muzikore, duke zbatuar procese të ndryshme muzikore si dëgjimin, krijimin, improvizimin etj. duke respektuar rregullat e performimit/interpretimit muzikor, ndarë përvojat e veta performuese me të tjerë dhe interpretuar në mënyrë artistike.


Nxënësi analizon veprat muzikore të interpretuara/ performuara, duke reflektuar dhe shpjeguar kuptimin e pjesëve muzikore të performuara, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik muzikor.

## **5 Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare**

Muzika është e lidhur me lëndët brenda fushës së saj, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul. Melodia, ritmi, harmonia, dinamika, tempa, forma, struktura etj. lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike si : kërcimin, artin pamor, teatrin, por edhe me matematikën, gjuhën dhe komunikimin, shkencat shoqërore etj. Kështu mësuesit duhet t'u japin mundësinë nxënësve të konsolidojnë dhe formojnë përvojat që ata kanë krijuar, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm këtyre përvojave.

Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlëndore të muzikës me lëndë të tjera, të para përmes njohurive.

Digrama 3: Lidhja ndërmjet muzikës dhe fushave të tjera





## **6 Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj**

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e muzikës synon të përmbushë 3 kompetencat e lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet 3 tematikave kryesore.

*Kompetencat e lëndës:*

Kompetenca 1: Krijimi muzikor.

Kompetenca 2: Performimi/interpretimi muzikor.

Kompetenca muzikore 3: Vlerësimi i veprave muzikore.


*Tematikës e lëndës:*

Tematika 1: Gjuha dhe komunikimi muzikor.

Tematika 2: Teknikat dhe proceset muzikore.

Tematika 3: Historia, muzika dhe shoqëria.

**Digrama 4 : Kompetencat që formohen përmes tematikave**



**Tabela 1: Kompetencat e veçanta dhe përshkrimi i tyre**

<b>Kompetencat e veçanta</b>	<b>Përshkrimi i kompetencave</b>
<b>Krijimi muzikor</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor ide të ndryshme për të organizuar krijimin muzikor;</li> <li>- përdor elementet muzikore gjatë krijimit;</li> <li>- zhvillon ide të reja gjatë krijimit muzikor;</li> <li>- organizon krijimin e vet muzikor, sipas rregullave të strukturës së periudhës muzikore;</li> <li>- ndan përvojat e veta krijuese me të tjerët.</li> </ul>
<b>Performimi/interpretimi muzikor</b>	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillon teknikat e këndimit, të luajtjes, së dëgjimit, analizimit, improvizimit në nivele të ndryshme;</li> <li>- perfeksion këndimin duke zbatuar teknikat performimit/interpretimit muzikor;</li> <li>- respekton rregullat e luajtjes në instrumente;</li> <li>- ndan përvojat e veta performuese me të tjerë.</li> </ul>
<b>Vlerësimi i veprave muzikore</b>	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon veprat muzikore që nga format e vogla e deri tek ato të mëdhatë;</li> <li>- vlerëson veprat muzikore, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.</li> </ul>

## 7 Koha mësimore për tematikë për secilën klasë

Lënda e muzikës zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 1 orë secila, pra gjithsej 35 orë për secilën klasë. Programi i lëndës së muzikës specifikon peshën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuara në planin mësimor të arsimit bazë. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

**Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë**

	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Teknikat dhe proceset	Historia, muzika dhe shoqëria	Gjithsej orë
<b>Klasa e gjashtë</b>	14	15	6	35 orë
<b>Klasa e shtatë</b>	10	15	10	35 orë
<b>Shkalla e tretë</b>	24	30	16	70 orë
	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Teknikat dhe proceset	Historia, muzika dhe shoqëria	Gjithsej orë
<b>Klasa e tetë</b>	8	14	13	35 orë
<b>Klasa e nëntë</b>	7	13	15	35 orë
<b>Shkalla e katërt</b>	14	28	28	70 orë

### **III. Përmbajtja e shkallës së tretë dhe të katërt**

Në programin e lëndës së muzikë për shkallën e tretë dhe të katërt janë paraqitur përmbajtjet e tematikave:

*Gjuha dhe komunikimi muzikor.*

*Teknika dhe procese muzikore.*

*Historia, muzika dhe shoqëria.*

Këto tematika janë bazë për të ndërtuar njohuri e shkathtësi dhe qëndrime e vlera. Tematikat janë bazë për të siguruar rezultatet e të nxënit, sipas kompetencave muzikore, për çdo shkallë të paraqitura në tabelë në fillim të çdo tematike.

Për secilën tematikë, sipas klasave të shkallës, janë paraqitur njohuritë për secilën klasë të shkallës së tretë (*klasa e gjashtë dhe klasa e shtatë*) dhe shkalla e katërt (*klasa e tetë dhe klasa e nëntë*). Aftësitë, qëndrimet dhe vlerat, që duhet të demonstrojnë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse, paraqiten vetëm në nivel shkalle (shkalla e tretë dhe shkalla e katërt).

Tematikat dhe renditja e tyre nuk presupozojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë sipas tematikave në këtë renditje. Kombinimi, ndarja e njohurive dhe koncepteve muzikore në situata të nxëni, grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (mësuesit dhe autorët e teksteve).

Për “përkthimin” e programit të shkallës në tekste mësimore apo programe lëndore për çdo vit mësimor, aftësitë dhe orët e tematikave do të jenë të shpërndara në tematika dhe njësi mësimore të zhvilluara logjikisht.

Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, ndërsa janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

Në program, për secilën klasë, afërsisht 40 % e orëve mësimore totale janë menduar për ndërtimin e njohurive të reja lëndore dhe 60 % e tyre janë menduar për krijimin e aftësive dhe situatave të të nxënit (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

## REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE, SIPAS TEMATIKAVE, SIPAS SHKALLËVE

### SHKALLA E TRETË: KLASA E GJASHTË, KLASA E SHTATË

#### 1.1. Tematika : Gjuha dhe komunikimi muzikor

##### PËRSHKRIMI I TEMATIKËS:

Melodia dhe ritmi janë pjesë e pandashme e njohurive të domosdoshme që duhet të dijë nxënësit për kuptimin e muzikës. Njohuritë , që do të vazhdojnë të merren, janë të shumta dhe kanë të bëjnë me mësimin e shkrimit muzikor si: *pentagrami, çelësi i solit, notat muzikore në vija dhe fusha, poshtë dhe sipër pentagramit, masa muzikore*, simbole të tjera si *lidhja vlerëse dhe shprehëse, shenja e përsëritjes*. Gjatësia e vlerave të notave dhe pushimeve , pika e vlerës, njohja me kohët e thjeshta  $2/4$ ,  $3/4$  dhe  $4/4$ ,  $3/8$ dhe kohët e përbëra  $6/8$ , tonalitetin, shkalla muzikore , akordi dhe arpezhi etj.do të zgjerojnë më tej njohuritë muzikore të nxënësit për kuptimin, krijimin ,interpretimin dhe gjykimin e saktë të muzikës që dëgjon apo performon. Gjithashtu ato zgjerojnë më tej panoramën mbi njohuritë muzikore.

##### REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS:

- *Krijimi muzikor*: krijon në kohët  $2/4, 3/4, 4/4, 3/8, 6/8$ ; krijon duke përdorur kombinime të ndryshme vlera notash dhe pushimesh; përdor simbole të ndryshme muzikore të mësuara duke krijuar diversitet në krijimin e vet; demonstroi kuptimin e tyre gjatë shpjegimit të krijimit të vet.
- *Performimi/interpretimi muzikor*: demonstroi gjatë interpretimit të këngëve simbolet muzikore; interpreton në kohët të ndryshme duke demonstruar se i ka kuptuar ato qartë; luan apo këndon duke respektuar simbolikat e mësuara; këndon ushtrime në kohët e mësuara;
- *Vlerësimi muzikor*: kupton dhe shpjegon ndryshimin e kohëve tek ushtrimet, këngët apo pjesët muzikore; zhvillon kuptimin e ritmeve muzikore të mësuara dhe pjesëve muzikore si p.sh: koha  $2/4$  - marshi, koha  $3/4$  - valsi etj.,; shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë respektimit të simboleve; demonstroi kuptimin e tonaliteteve muzikore;

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
<b>KLASA 6</b>	
<p>› <b>Melodia:</b></p> <p><b>Shkrimi muzikor:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pentagrami.</li> <li>- Çelësi muzikor i solit.</li> <li>- Notat muzikore në vija dhe fusha.</li> <li>- Poshtë dhe sipër pentagramit.</li> <li>- Masa muzikore.</li> <li>- Lidhja vlerëse dhe shprehëse.</li> <li>- Shenja e përsëritjes.</li> </ul> <p>› <b>Ritmi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Piramida e notave dhe pushimeve.</li> <li>- Nota tetëshe 1/8 dhe pushimi i saj.</li> <li>- Kohët 2/4.</li> <li>- Pika e vlerës.</li> <li>- Koha ¾.</li> <li>- Koha 4/4.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kupton pse shërben <i>pentagrami</i> në muzikë;</li> <li>- kupton rolin e <i>çelësit të solit</i> në muzikë;</li> <li>- shkruan në pentagram <i>notat muzikore vija</i> dhe në <i>fusha, sipër</i> dhe poshtë <i>pentagramit</i>, duke kuptuar lartësinë e tyre;</li> <li>- demonstroi se kupton <i>piramidën e vlerave (gjatësive) të notave dhe pushimeve</i>;</li> <li>- shkruan dhe lexon notat muzikore në pentagram;</li> <li>- kupton funksionin në muzikë të <i>masës muzikore</i> dhe e përdor gjatë krijimeve të veta;</li> <li>- demonstroi kuptimin e përdorimit të simboleve muzikore <i>lidhjes vlerëse dhe shprehëse, shenjave të përsëritjes</i>;</li> <li>- zbaton në shembuj të thjeshtë ritmikë dhe melodikë <i>lidhjen vlerëse dhe shprehëse</i>;</li> <li>- demonstroi kuptimin e <i>pikës së vlerës</i> në muzikë gjatë leximit apo këndimit të shembujve muzikorë;</li> <li>- demonstroi kuptimin e kohëve 2/4,3/4,4/4 në muzikë;</li> <li>- lexon në kohët 2/4, 3/4, 4/4 , duke zbatuar kërkesat gjatë leximit;</li> <li>- krijon ushtrime ritmike apo melodike në kohët 2-3-4 ritmike dhe shpjegon rrugët që ka ndjekur për t'i krijuar ato.</li> </ul>
<b>KLASA 7</b>	
<p>› <b>Ritmi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3/8</li> <li>- 6/8</li> <li>- Nota 1/16</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi kuptimin e kohëve 3/8 dhe 6/8, përmes shembujve ritmikë dhe melodikë;</li> <li>- kupton ndryshimin midis 3/8 ( kohë e thjeshtë) dhe 6/8 ( kohë e përbërë);</li> <li>- lexon dhe shkruan ushtrime në kohët 3/8 dhe 6/8;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Masa e paplotësuar</li> </ul> <p>&gt; <b>Harmonia:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkalla muzikore, akordi/arpezi</li> <li>- T dhe ½ T</li> <li>- Shkalla DO+ (maxhore) &amp; shkalla La – (minore)</li> <li>- Tonaliteti</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi kuptimin e gjatësisë së notës dhe të pushimit 1/16;</li> <li>- lexon ritmikisht shembuj në kohët 3/8 dhe 6/8;</li> <li>- demonstroi kuptimin e <i>mases së paplotësuar</i>;</li> <li>- krijon dhe shpjegon krijimet e veta në kohët 3/8 dhe 6/8;</li> <li>- kupton ndërtimin e shkallës muzikore dhe funksionin e <i>akordit</i> dhe <i>arpezhit</i>;</li> <li>- kupton dhe zbaton <i>tonin</i> dhe ½ <i>tonin</i> në ndërtimin e shkallëve muzikore muzikore;</li> <li>- ndërton dhe këndon shkallën DO+ (maxhore) &amp; shkalla La – (minore);</li> <li>- kupton rolin e <i>tonalitetit</i> në muzikë, duke sjellë shembuj nga veprat muzikore;</li> <li>- respekton në këngë, ushtrime apo shembuj ritmikë apo melodikë të gjitha shenjat dhe simbolet e mësuara.</li> </ul>
---	---

## 1.2. Tematika: Teknika dhe procese muzikore

### PËRSHKRIMI I TEMATIKËS:

Teknikat dhe proceset muzikore vazhdojnë të zhvillohen më tej në këtë shkallë. Këndimi, luajtja në instrumentin e fyellit, zhvillohen nëpërmjet teknikave të ndryshme të kënduarit dhe luajtjes në instrument, ndërsa përjetimi, interpretimi, dëgjimi muzikor, krijimi, improvizimi, analizimi zhvillohen përmes proceseve. Përmes të kënduarit zhvillohen më tej mënyrat e formësimit të zërit dhe të një të kënduari të saktë në intonacion e në një ritëm të caktuar. Përmbajtjet e këngëve janë të thjeshta dhe vazhdojnë të ruajnë tematika të tilla si: *himni, atdheu, familja, shoqëria, këngët patriotike dhe festat e ndryshme* etj. Po kështu edhe *këngë për të rinj* apo *popullore*. Ato janë didaktike dhe kanë vlera artistike muzikore - poetike, të cilat edukojnë për një qëllim të caktuar, ndaj tematika e tyre është e detyrueshme. Këngët duhet të jenë të thjeshta për nga *shtrirja e regjistrit vokal (zërit), melodia* duke përfshirë edhe ritmet 3/8 dhe 6/8. Ndërsa luajtja në instrumentin e fyellit bëhet me nota muzikore.

### REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS:

- *Krijimi muzikor*: demonstroi zbatimin e njohurive të mësuara në këtë shkallë, gjatë këndimit apo gjatë luajtjes në instrument; komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon.
- *Performimi/interpretimi muzikor*: këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; luan me instrumentin duke



respektuar ritmet muzikor; interpreton këngët në kohët e mësuara duke respektuar ritmin, intonacionin dhe simbolikat e mësuara; interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; performon/interpreton këngët në eventet e klasës apo të shkollës.

- *Vlerësimi i veprave muzikore*: shpreh emocionet e veta për këngët që këndon; përdor një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, gjatë përjetimit emocional të pjesëve muzikore që dëgjon; përjeton muzikën e këngëve dhe përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; respekton interpretimin dhe performimin e shokëve; ndan përvojën e vet artistike me të tjerët, respekton këngë të kulturave të tjera;

### Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës

### Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

#### KLASA 6

#### › Këndimi solo dhe në grup

Nxënësi:

- këndon këngë me tematika të larmishme (*himni, atdheu, familja, shoqëria, këngët patriotike dhe festat e ndryshme* etj.;, po kështu edhe *këngë për të rinj apo popullore*), në kohë të ndryshme të thjeshta dhe të përbëra, me një regjistër të thjeshtë vokal, me shtrirje brenda oktavës qendrore, nga notat Do – Do<sup>2</sup>;
- respekton rregullat e këndimit gjatë të kënduarit;
- respekton gjatë këndimit *ritmin, intonacionin, karakterin e këngës*;
- këndon *solo dhe në grup*;
- interpreton këngët e mësuara me emocion dhe ndjenjë;
- luan në instrumentin e fyellit sipas notave muzikore dhe kohëve të mësuara (kohët e thjeshta);
- respekton rregullat e luajtjes në instrument;
- merr pjesë në aktivitetet e klasës dhe shkollës;
- regjistron krijimet e tyre në instrument dhe zë (luajtje në instrument dhe këngë në magnetofonin e klasës, shkollës).

#### › Instrumenti i fyellit:

- Rregullat e luajtjes në instrument.
- Qëndrimi.
- Teknika të luajtjes me to.

#### KLASA 7

Nxënësi:

### › Këndimi solo dhe në grup

- këndon: këngë tematike për fëmijë (të rinj), këngë të krahinës, këngë të huaja, në kohë të ndryshme të thjeshta dhe të përbëra, me një regjistër të thjeshtë vokale, me shtrirje brenda oktavës qendrore, nga notat Do – Do<sup>2</sup> (me një ose dy zëra);
- respekton rregullat e këndimit gjatë të kënduarit;
- respekton gjatë këndimit *ritmin, intonacionin, karakterin e këngës*;
- këndon *solo dhe në grup*;
- interpreton këngët e mësuara me emocion dhe ndjenjë;
- merr pjesë në aktivitetet e klasës dhe shkollës;
- regjistron krijimet e tyre me instrumente dhe zë, në magnetofonin e klasës, shkollës.

### 1.3. Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria

#### PËRSHKRIMI I TEMATIKËS:

Dëgjimi muzikor, përjetimi dhe të shprehurit emocional ndaj muzikës, është një proces shumë i rëndësishëm. Muzika krijon emocione, që shprehin: dashuri, kënaqësi, keqardhje, gëzim, shpresë, mërzi dhe cilat si mendime muzikore është zhvilluar në hapësirë dhe në kohë. Muzika shfaqet si një ndërthurje elementesh që jo gjithmonë janë të shpallura në kuadrin e formës muzikore dhe po ashtu, jo gjithmonë i përkasin thjesht dhe vetëm përmbajtjes. Njohja me ndryshueshmërinë e muzikës monodike dhe polifonike dhe kuptimi i formave muzikore, njohja me instrumentet muzikore në grupet, ku ato bëjnë pjesë, është i domosdoshëm në këtë shkallë.

Ndërsa përdorimi i teknologjive të ndryshme ndihmon dhe është në funksion të kërkimit të të dhënave, prezantimit, regjistrimeve.

#### REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS:

- *Krijimi muzikor*: provon të këndoje fragmente të vogla muzikore për të kuptuar *ndryshueshmërinë e muzikës*; krijon një motiv muzikor të personalizuar; imiton me zë ose fishkëllimë motive nga vepra të ndryshme muzikore.
- *Performimi/interpretimi muzikor*: interpreton me zë ose fishkëllimë motivet nga vepra të ndryshme muzikore; performon / interpreton këngë të

ndryshme me emocion; vlerëson interpretimin dhe performimin e të tjerëve; përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar /prezantuar punën e vet; ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

- *Vlerësimi i veprave muzikore:* bën lidhje ndërmjet asaj që di mbi format muzikore, instrumentet apo vokalin dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore; bën gjykime kritike ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në gjuhën muzikore *ndryshueshmërinë e ritmeve muzikore, shpejtësinë muzikore, formën muzikore, karakterin e pjesëve muzikore;* ndan përvojën/mendimin e vet artistik me të tjerët; dëgjon dhe komunikon mendimin e vet rreth veprave muzikore të dëgjuara; reflekton emocionet që i krijon një vepër muzikore gjatë kohës që interpretohet/luhet; shpreh mendimin e vet rreth pjesës muzikore që dëgjon; përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; respekton mendimin e shokëve; respekton pjesë muzikore të kulturave të tjera; merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.

**Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës**

**Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës**

**KLASA 6**

› **Format muzikore :**

- Struktura muzikore: motivi, fraza, fjalia dhe periudha - (motivi) simfonia 5 – L.V.Bethoven.

› **Ndërtimi muzikor *monodik* dhe *polifonik:*** kanoni, kënga, minueti.

- *Nxënësi:*
- demonstroi kuptimin e *motivit, frazës, fjalisë* dhe *periudhës muzikore;*
- demonstroi kuptimin e ndryshueshmërisë së muzikës instrumentale dhe vokale, duke dhënë veçoritë e secilës pjesë muzikore: *kanonit, këngës, minuetit* shembuj muzikore: kanone të ndryshme, kënga e Solvegut nga Per Gynt – Eduard Grieg, minueti në G maxhor, J.S.Bah;
- dëgjon pjesët muzikore, duke shprehur emocionet lidhur me muzikën dhe përcakton formën në të cilën është paraqitur - instrumentale, vokale, orkestrale;
- dëgjon dhe argumenton nga dëgjimi muzikor i pjesëve *temën muzikore* dhe *gjendjen emocionale* që krijon ajo ( vepra instrumentale);
- dëgjon dhe argumenton nga dëgjimi muzikor, *temën e një vepre muzikore,* si kalon ajo nga instrumenti në instrument dhe si komunikojnë instrumentet me njëri – tjetrin, duke paraqitur mendimin e plotë muzikor (vepër orkestrale);
- demonstroi ndryshueshmërinë e muzikës që dëgjon, duke përdorur fjalor të thjeshtë muzikor: *e shpejtë, e ngadaltë, e qetë, ëmbël, minuet* etj.

## KLASA 7

### › Klasifikimi i zërave vokale në muzikë :

- zërat e fëmijëve, të bardhë,
- zërat e grave (*soprano, mexosoprano, alto*),
- zërat e burrave (*tenor, bariton, bas*),  
*kori i fëmijëve -akti I opera Karmen, Zh.Bize;*  
*aria e Violetës – opera Traviata, XH.Verdi;*  
*La Donna e mobile – Opera Rigoletto, Xh. Verdi.*

### › Klasifikimi i instrumenteve muzikore:

Grupi i instrumenteve aerofonë, kordofonë, membranofone, idiofonë:

- *Koncert për violinë – N.Paganini.*
- *Sonata e hënës – L.V.Bethoven.*

### › Orkestra muzikore

- banda
- kuarteti
- ansambli i dhomës
- orkestrat e vogla
- orkestra simfonike.

### › Format muzikore 1-2-3 pjesëshe.

### › Teknologjia:

*Nxënësi:*

- klasifikon zërat vokale nga më i ulëti te më i larti (*bas, bariton, tenor, alto mexosoprano, soprano*);
- klasifikon gjatë dëgjimit zërat e grave duke i përcaktuar saktë ato (*alto mexosoprano, soprano*);
- klasifikon gjatë dëgjimit zërat e burrave duke i përcaktuar saktë ato (*bas, bariton, tenor*);
- klasifikon *instrumentet muzikore*: instrumente kordofonë, aerefone, idiofone, membranofone dhe elektrike, përmes dëgjimit dhe pamjes: instrumentet e harqeve (violina); instrumentet me goditje (pianoja); instrumentet me frymë (klarinetat); instrumentet elektrike (kitara);
- dallon *llojet e orkestrave*, duke përcaktuar instrumentet që bëjnë pjesë në të;
- evidenton llojin e orkestrës që i pëlqen më shumë dhe pjesët muzikore që luhen nga ajo;
- klasifikon llojin e orkestrës, pas dëgjimit të pjesës instrumentale apo vokale, të ekzekutuara nga ato;
- dëgjon fragmente të vogla muzikore, ku ata diskutojnë rreth njohurive që ka marrë rreth *format, zërat vokale, instrumentet muzikore*;
- dëgjon variante të së njëjtës formave muzikore 1-2-3 pjesëshe, por nga kompozitorë të ndryshëm, duke demonstruar kuptimin e tyre;
- demonstroi kuptimin e ndryshueshmërisë e formave muzikore 1-2-3 pjesëshe nëpërmjet dëgjimit (*tema me variacion, rondo, fuga*): p.sh.: K 265 Moxart - tema me variacion, V.A.Moxart – rondo; marshi turk; J.S.Bach - fuga -nr 2;
- dëgjon dhe argumenton gjendjen emocionale që i krijojnë pjesët muzikore;
- argumenton muzikën që dëgjon, duke përdorur fjalor të thjeshtë muzikor;
- respekton përjetimin dhe vlerësimin e të tjerëve;

- kërkim të dhënash, prezantim, regjistrime audio dhe video me mjete të ndryshme të teknologjisë;

- prezanton informacionin e mbledhur për instrumentet muzikore dhe këngëtarët e ndryshëm;
- përdor mjete të ndryshme të teknologjisë për të mbledhur dhe prezantuar informacionin muzikor.

### **Qëndrime dhe vlera**

#### **Nxënësi :**

- dëgjon dhe shpreh mendimin e vet të bazuar në njohuritë muzikore mbi formën muzikore, tonalitetin, ritmet etj;
- përjeton dhe shpjegon emocionin e krijuar nga dëgjimi i veprave muzikore përmes shpjegimit konkret;
- shpreh idetë e veta për muzikën që dëgjon;
- shprehet duke komunikuar artistikisht për një pjesë muzikore;
- demonstroi vetëbesim në aktivitete të ndryshme muzikore/artistike;
- komunikon në mënyrë të pavarur;
- merr pjesë aktive në veprimtaritë muzikore vetëm dhe në grup;
- përdor imagjinatën dhe kreativitetin për të krijuar dhe interpretuar muzikën në grup;
- krijon me vetëbesim punë të veta muzikore;
- bashkëpunon vetëm dhe me të tjerë në një veprimtari muzikore;
- respekton diversitetin ndaj kulturave të ndryshme muzikore që dëgjon, përjeton apo njih;
- respekton krijimet e veta dhe të tjerëve;
- zhvillon një gjykim të saktë ndaj këngëve apo veprave të ndryshme muzikore që dëgjon;
- performon duke demonstruar njohje shumë të mirë të kulturës kombëtare apo të kulturave të tjera;
- zhvillon frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë proceseve të ndryshme artistike;
- përqendrohet dhe tregon durim gjatë punëve krijuese dhe interpretuese.

### III. Udhëzime metodologjike

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënimit të muzikës është kusht për rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor/artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimin të muzikës do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete krijuese, ku ata përjetojnë dhe provojnë vetë gjatë proceseve muzikore. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet motivimit dhe përkundrejt zhvillimit të kompetencave të caktuara si dhe tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e muzikës, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari krijuese, shprehëse, emocionale. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore muzikore është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit drejtohen drejt saj në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit intelektual/krijues dhe artistik në shumë aspekte.

Mësimdhënia e muzikës, synon gjithëpërfshirjen dhe bazohet ***në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca; mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien e nxënien e integruar.***

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në mësimin e muzikës mban parasysh:

- kompetencat kryesore të të nxënimit në muzikë;
- lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- vazhdimin e formimit dhe forcimin aftësive dhe shprehive muzikore;
- rëndësinë e zbatimeve krijuese/interpretuese/vlerësuese muzikore, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet muzikore me situata të jetës reale;

- rëndësinë e përdorimit të mjeteve muzikore konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë Cd, Dvd, kompjuter, magnetofon;
- veçoritë e interpretimit në mënyrë individuale dhe në grup;
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së muzikës dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi të jenë plotësues të njëri-tjetrit.

Një mësimdhënie planifikuar mirë, krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat muzikore janë të përcaktuara në këtë program janë të ndërlidhura dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Ata janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, krijime ose simulime të njohurive, interpretime/performime, gjykimeve dhe qëndrimeve. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në muzikë;

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësi të punojë me situata ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si :“Pse më pëlqen?”, “A është melodioze?”, “Cilat instrumente dëgjoj?”, ”Pse shquhet ky kompozitor ? etj. Në këtë mënyrë ai inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e veta dhe të zhvillojë situata të reja.

Projektet kurrikulare afatgjata nga njëra anë lejojnë nxënësin të zbatojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron dhe nga ana tjetër arrin të krijojë lidhje integruese me lëndë të tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj. Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave muzikore/artistike, por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.

#### IV. Udhëzime për vlerësimin

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënësve bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqëndrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e kompetencave, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësit me informacionin përkatës për progresin e tij. Sigurisht është i domosdoshëm edhe vlerësimi i përmbajtjes lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive muzikore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre (*psh; vetëvlerësimi, interpretimi i një liste këngësh për të rinj, portofoli me punë muzikore, prezantimi me gojë të kompozitorëve të ndryshëm*).

Vlerësimi përshkon gjithë procesin mësimor dhe i shërben përmirësimit të këtij procesi; Në muzikë, ndryshe nga lëndët e tjera, mbështetet në parimin e krijimit individual, ku çdo nxënës posedon dhe zhvillon prirjet e veta të veçanta, duke u shprehur në mënyrë individuale. *Inkurajimi, imagjinata muzikore, shprehja origjinale dhe krijuese, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi* i punëve muzikore janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në muzikë dhe arte. Gjithashtu, pjesëmarrja individuale, por edhe në grup, në aktivitetet artistike të ndryshme që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësve dhe objekt i vlerësimit janë puna për formimin e kompetencave muzikore tek nxënësit, që ai/ajo të jetë në gjendje të krijojë, performojë/interpretojë dhe vlerësojë saktë dhe bukur muzikën. Arritjet në fushën e muzikës dhe të arteve janë më shumë individuale, prandaj duhet edhe të vlerësohen si të tilla.

Kjo gjë bëhet në funksion të matjes së kompetencave muzikore, që arrin të zhvillojë dhe demonstrojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes *të kënduarit, të dëgjuarit muzikor, të krijuarit, të analizuarit të pjesëve artistike* etj.

Portofoli i nxënësit është një tjetër mundësi vlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor në muzikë. Ai mund të përmbajë krijime, projekte kurrikulare, prodhime të ndryshme të CD-ve e DVD-ve në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, etj.

Vlerësimi i nxënësve në shkollën e tretë bëhet sipas kompetencave përkatëse që ata duhet të zhvillojnë.



## V. Materiale dhe burime mësimore

Gjatë mësimit të muzikës për realizimin e kompetencave, mësuesi përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai/ajo përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon mjedisin e përshtatshëm për aktivitete. Teknologjia ka një ndikim të madh në muzikë duke ndihmuar nxënësit të eksplorojnë këngë me tematikë të ndryshme, për të rinj, arie, mjuzikëll, vepra muzikore të ndryshme, duke zhvilluar aftësitë e tyre në njohjen më të plotë të muzikës.

Tekstet dhe materialet sigurojnë një qasje përmes përdorimit të tyre të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Me anë të medieve, detyrave dhe projekteve të ndryshme u krijohet mundësia nxënësve të demonstrojnë apo prezantojnë punët dhe krijimet e tyre.

Muzika studiohet përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve, materialeve, teknikave e procedurave specifike muzikore, p.sh: për dëgjim muzikor, shikim të shfaqjeve për ndjekjen e pjesëve muzikore, këngëve përdoren magnetofoni, TV, CD dhe DVD .

Përveç materialeve shfrytëzohen edhe burime mësimore si teksti shkollor, interneti etj.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- *Mjetet audiovizive si:* Tv, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.
- *Mjetet dëgjimore:* radio, magnetofon, etj.
- *Mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për muzikën. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre krijuese dhe performuese, si dhe në kryerjen e krijimeve të ndryshme.
- *Mjedisi mësimor* (klasa, kabinetet e muzikës etj.).